DATË/A:	*20.10.2022*
Për/To/Za :	*ASAMBLEJA KOMUNALE DEÇAN – z. Hajdar Sutaj- Kryesues*
Nga/From/Od	*Znj. Dafina Cacaj -Drejtore për Buxhet dhe Financa*
Përmes:	*z. Bashkim Ramosaj – Kryetar i Komunës*
Tema/Subject/Subjekat	*Kërkesë*

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E DEÇANIT · Kryetari i Komunës · REPUBLIKA KOSOVA · OPSTINA DEÇANE · DEÇAN MUNICIPALITY · REPUBLIC OF KOSOVA

Të nderuar,

Të nderuar asamblist, kërkoj nga ju shqyrtimin e kërkesës së Drejtorisë për BF dhe marrjen e vendimit për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, në shumën 17,600.00 €.

Ju lutem ne bashkëngjitje e gjeni dokumentin, Marrëveshja e Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë.

DBF është e hapur për te gjitha sugjerimet dhe sqarimet e nevojshme.

Sinqerisht

Znj. Dafina Cacaj -Drejtore për Buxhet dhe Financa

MËSHQERRA
ORGANIZATA PËR ZHVILLIM RURAL
ORGANISATION FOR RURAL DEVELOPMENT

7. Kryetari 4117
02 01.02.22

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

1) **Në mes të:**

a) Komunës së Deçanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **z. Bashkim Ramosaj** dhe,
b) Organizatës Për Zhvillim Rural (OZHR) "Mëshqerra" – Prishtinë, me adresë: Ulpiana U1, H6/5 Prishtinë, përfaqësuar nga **znj. Florentina Kida Gërguri**, drejtor.

2) **Palët e lartshënuara pajtohen me sa vijon:**

a) Komuna e Deçanit dhe OZHR"Mëshqerra", kanë bërë këtë marrëveshje bashkëpunimi që të realizojnë një projekt të përbashkët nga lëmia e blegtorisë për fermerët e Komunës së Deçanit.

b) Projekti do të zgjat tre vite (2022-2024), dhe vlera totale e këtij projekti është 64,850.00 € (Gjashtë dhjetë e kater mijë e tetë qind e pesëdhjetë euro), në këtë vlerë, OZHR "Mëshqerra" do të participoj me 59.30 % (64,850.00) të vlerës, komuna e Deçanit do të participoj me 27.13 % (17,600.00 €) të vlerës dhe fermerët përfitues do të participojnë me 13.57 % (8,800.00 €) të vlerës së këtij projekti.

c) Përmbajtja e projektit:
- Mëshqerra barrëse (Raca Hollshtajn) 22 krerë
- Transporti i mëshqerrave Irlandë- Kosovë
- Akomodimi i mëshqerrave në karantinë dhe transporti i tyre deri te fermerët
- Ushqim të Koncentratruar dhe inpute tjera
- Shërbime veterinere dhe vlerësim projekti
- Trajnime, vizita për fermerë
- Shpenzime të udhëtimit
- Personeli
- Administrata dhe shpenzimet e zyrës

d) - Fermerët do të përzgjidhen nga Komuna e Deçanit dhe Organizata Për Zhvillim Rural (OZHR) "Mëshqerra" – në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës

3) Obligimet e palëve:

a) Donator do të jetë Organizata "Bothar" nga Irlanda, ndërsa zbatues të projektit do të jenë Komuna e Deçanit dhe OZHR "Mëshqerra" në Prishtinë.
b) OZHR "Mëshqerra" gjatë muajit Shkurt, do të siguroj përmes donatorit organizata "Bothar" nga Irlanda 22 krerë mëshqerra barrëse (Raca Hollshtajn), për fermerët përfitues në Komunën e Deçanit.
c) Komuna Deçanit, zotohet se gjatë vitit buxhetor të 2022, do të transferoj shumën prej 27.13 % (17,600.00 €) (Shtatëmbëdhjetë mijë e Gjashtëqind euro) në xhirollogarinë e OZHR "Mëshqerra" (Raiffeisen Bank 1501130000416395), pas shpërndarjes së mëshqerrave te përfituesit.
d) Fermerët, për participim do të transferojnë mjetet në xhirollogarinë e OZHR "Mëshqerra" (Raiffeisen Bank 1501130000416395), para shpërndarjes së mëshqerrave të përfituesit.
e) Komuna e Deçanit (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), do të ndihmojë në zbatimin e projektit në teren.
f) Thirrja publike bëhet nga komuna e Deçanit (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), dhe shpërndahen në vendet publike në komunën e Deçanit dhe në website e komunës.
g) Kriteret për ndarjen e mëshqerrave përcaktohen nga Komuna e Deçanit (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural) dhe OZHR "Mëshqerra".
h) Aplikacionet merren, plotësohen dhe dorëzohen në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Deçanit.
i) Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, 3 nga Komuna e Deçanit (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural) dhe 2 nga organizata OZHR " Mëshqerra ".
j) OZHR "Mëshqerra" planifikon që gjatë vitit 2022 të realizoj edhe një projekt me mëshqerra me Komunën e Deçanit.

4) Raportimi:

a) OZHR "Mëshqerra" gjatë realizimit të projektit, do të përgatisë raporte të nevojshme për gjendjen e projektit.

Marrëveshja përgatitet në tre kopje dhe hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të palëve.

Deçani, **më:** 07/02/2022

Kryetari i Komunës së Deçanit

Z. Bashkim Ramosaj

Drejtor OZHR "Meshqerra"

Znj. Florentina Kida Gërguri

F. Kida